



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË




NIPT.L11913019B

Nr.16/2019 .Dosje/Nr.1460.Prot.

Tiranë, më 17.04.2019

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)



Drejtuar: Qendres Kombetare te Biznesit QKB-Tirane

Une Endrit Hasa, me detyre permbarues gjyqesor prane Shoqërisë së Përmbarrimit “Bailiff Services-Matani & Co” sh.p.k, në referim të Titullit Ekzekutiv, Fatura Tatimore e shitjes TT2549800, date 18.09.2018, Nr serial 226772497 eshte vënë në ekzekutim ky Titull, duke regjistruar në dosjen përmbarrimore Nr.16/2019, datë 25.03.2019, kërkesën e kreditorit Shoqeria “Pharma One ” sh.p.k, ndaj debitorit Shoqeria “CFO PHARMA” sh.p.k me Nipt K22305002U, ku është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi Nr.1300. Akti, datë 01.03.2019 i Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Tirane. Pasi studiova materialin e dosjes përmbarrimore Nr.16/2019, datë 25.03.2019, konstatoj se:

Në bazë të Urdherit te Ekzekutimit Vendimi Nr.1300. Akti date 01.03.2019 i Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tiranë është vendosur :

1. Pranimi i kerkeses.
2. Leshimin e urdherit te ekzekutimit per Fatura Tatimore e shitjes TT2549800, date 18.09.2018, Nr Serial 226772497 leshuar nga kreditori Pharma One sh.p.k regjistruar ne QKB me date 28.10.2007 me qender ne Kashar, Tirane autostrada Tirane –Durrës Km 6, me administrator Z. Ben Petani, Nipt K72228008B kundrejt debitorit Shoqeria CFO Pharma sh.p.k , me qender ne Tirane , Kashar, rruga Pavarsia dhe administrator Z. Nadir Causholli, Nipt K22305002U per ekzekutimin e detyrimit ne vleren 16,450,666 Leke dhe kamatvonesat mbi kete shume te llogaritura sipas nenit 5 te ligji 48/2014 “Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore dhe tregtare”.
3. Ngarkohet sherbimi permbarimor per ekzekutimin e ketij vendimi.
4. Ky Vendim hartohet vetem ne nje kopje.
5. Shpenzimet gjyqesore i ngarohen kerkuesit.

Bazuar në nenin 517 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafët I dhe II të tij, lajmërova dhe kërkova përmbushjen dhe ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi Nr.1300. Akti, datë 01.03.2019 i Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Tirane, duke respektuar afatin 10-ditor, që prej marrjes së këtij lajmërimi.

Debitori Shoqeria “CFO PHARMA” sh.p.k, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i eshte përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi. Në këto kushte në referim të nenit 519, 527 të K.Pr.Civile eshte vijuar me ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi llogarinë e palës debitore Shoqeria “CFO PHARMA”sh.p.k me Nipt K22305002U , në masën e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 519, 527 i K.Pr.Civile dhe neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat.

URDHËROJ:

1. Vendosjen e shënimit në regjistrat e QKB-së, për subjektin Shoqeria "CFO PHARMA" sh.p.k identifikuar me Nipt K22305002U me administrator Nadir Çausholli si më poshtë:

"Ndalimin e tjetërsimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi kredit e debitorit Shoqerise "CFO PHARMA" sh.p.k identifikuar me Nipt K22305002U me administrator Nadir Çausholli, duke paralajmëruar çdo zyrë noteriale se çdo akt i ndërmarë pas këtij shënimi përbën shkelje ligjore referuar nenit 531 e vijues të K.Pr.Civile, të Ligjit nr.7829 datë 01.06.1994 " Për noterinë" dhe nenit 428 dhe 320 i K.Penal.

2. Ky urdhër të qëndroj i regjistruar në regjistrat e QKB-së deri në shlyerjen e plotë të detyrimit në zbatim të *Urdhërit të Ekzekutimit* Vendimi Nr.1300. Akti, datë 01.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.
3. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
4. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së pasurive të luajtshme apo te paluajtshme në emër të debitorit përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas Nenit 606/3 Kodi i Procedurës Civile dhe 320 i Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

Shoqeria Përmbarrimore "Bailiff Services Matani&Co"sh.p.k

Përmbarrues GJYQËSOR

Endrit Z. Hasa

